

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-01 Primer

PRAJMER ME BAZË UJI PËR DYSHEMETË, PËRDORET PËR PËRBËRËSIT E NIVELIT DHE KOLLAT E PLLAKAVE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-01 Primer është koncentrat rrëshire sintetike me 1 përbërës dhe me bazë uji që dallohet me ujë dhe përdoret si prajmer për nënshtresat e dyshemeve me bazë çimentoje, prej druri dhe mastiku asfaltik.

Aplikohet përpara përdorimit të produkteve me bazë çimentoje për nivelim dhe kollave të pllakave, kryesisht për të reduktuar absorbueshmërinë dhe përmirësimin e ndërkapjes me nënshtresën. Për përdorim të brendshëm.

PËRDORIMET

Si prajmer për:

- Reduktimin e absorbueshmërisë së nënshtresës
- Përmirësim i ndërkapjes me nënshtresat e lëmuara dhe të qëndrueshme
- Mbrojtje e nënshtresës ndaj lagështisë nga përbërësit e nivelimit me bazë çimentoje ose kollat e pllakave

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Absorbueshmëri e reduktuar
- Përmirësim i ndërkapjes mbi nënshtresat e lëmuara/ niveluara dhe të qëndrueshme
- Mbrojtje e nënshtresës ndaj transferimit të lagështisë nga produktet e aplikuar të nivelimit
- Konsumim i ulët / mbulim i madh
- I përshtatshëm për aplikime tek sistemet e ngrohjes nëndysheme
- Kohë e shkurtër pritjeje
- Redukton formimin e pluhurit
- Kompatibilitet me nënshtresat e përcaktuara
- Çlirime shumë të ulëta
- Mund të spërkatet
- Aplikim me furçë, rul ose spërkatje
- Mund të dallohet me ujë
- Gati për përdorim
- Pa tretës sipas TRGS 610

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Deklarata IBU e produktit për mjedisin (EPD)
- Klasifikimi VOC për çlirimet GEV-Emicode EC1^{PLUS}, nr. i licensës 6158/24.02.97

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|---|
| Baza kimike | Tretësirë sintetike |
| Ambalazhi | Enë 1kg, 10kg dhe 5 kg |
| Paraqitja / Ngjyra | Lëng blu |
| Jetëgjatësia | 12 muaj nga data e prodhimit |
| Kushtet e magazinimit | Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal të vulosur, të pahapur dhe të padëmtuar kushte të freskëta dhe temperatura midis +5 °C dhe +30 °C. Lexoni gjithmonë ambalazhin. Materiali që është përzierë me ujë duhet të përdoret brenda 1 jave. |
| Dendësia | ~1,0 kg/l |

Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-01 Primer

Tetor 2019, Botimi 05.01

020815120010000042

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| Nënshtresat | Kompatibiliteti i nënshtresave: <ul style="list-style-type: none">▪ Beton▪ Dysheme me bazë çimentoje▪ Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti)▪ Nënshtresa me mbetje ekzistuese adezivi me rezistencë ndaj ujit▪ Druri: pllakë zdrukthi dhe OSB▪ Pllaka qeramike▪ Dysheme mastiku asfaltik IC 10 dhe IC 15 sipas EN 13 813▪ Për lloje të tjera nënshtresash, kontaktoni me shërbimin teknik Sika | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|--|-------------------|-------------|--------------------------------------|------------|---|------------|--|---------|-------------------------|--------|--|---------|
| Raporti i përzjerjes | Nënshtresa Dysheme çimentoje ose betoni Dysheme sulfati kalciumi (anhidrit) Pllaka qeramike, mbetje adezivi të vjetër me rezistencë ndaj ujit, pllakë zdrukthi ose OSB, mastik asfaltik | Hollimi. Sikafloor®-01 Primer : Ujë 1 kg : 3 l ujë 1 kg : 1 l ujë Aplikoni pa hollim | | | | | | | | | | | | |
| Konsumimi | ~70 g/m ² Kjo vlerë është teorike dhe nuk përlogarit asnjë material shtesë për shkak të porozitetit apo profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj. | | | | | | | | | | | | | |
| Temperatura e mjedisit | +5 °C min. / +30 °C max. | | | | | | | | | | | | | |
| Temperatura e nënshtresës | +5 °C min. / +30 °C max. | | | | | | | | | | | | | |
| Koha e pritjes / mbiveshja | Përbërës për nivelim dhe kolla pllakash mbi Sikafloor®-01 Primer <table><thead><tr><th>Nënshtresa</th><th>Min.</th></tr></thead><tbody><tr><td>Dysheme me bazë çimentoje ose betoni</td><td>~10 minuta</td></tr><tr><td>Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti) *</td><td>~10 minuta</td></tr><tr><td>Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti) **</td><td>~24 orë</td></tr><tr><td>Pllakë zdrukthi ose OSB</td><td>~2 orë</td></tr><tr><td>Pllaka qeramike, mbetje e vjetër adezivi me rezistencë ndaj ujit, dysheme mastiku asfaltik</td><td>~12 orë</td></tr></tbody></table> <p>*Janë përdorur përbërës për nivelim me bazë sulfati kalciumi. **Janë përdorur përbërës për nivelim me bazë çimentoje. Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative. Duhet të referoheni tek skdat teknike përkatëse të përbërësve për nivelim dhe kollave të pllakave.</p> | | Nënshtresa | Min. | Dysheme me bazë çimentoje ose betoni | ~10 minuta | Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti) * | ~10 minuta | Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti) ** | ~24 orë | Pllakë zdrukthi ose OSB | ~2 orë | Pllaka qeramike, mbetje e vjetër adezivi me rezistencë ndaj ujit, dysheme mastiku asfaltik | ~12 orë |
| Nënshtresa | Min. | | | | | | | | | | | | | |
| Dysheme me bazë çimentoje ose betoni | ~10 minuta | | | | | | | | | | | | | |
| Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti) * | ~10 minuta | | | | | | | | | | | | | |
| Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti) ** | ~24 orë | | | | | | | | | | | | | |
| Pllakë zdrukthi ose OSB | ~2 orë | | | | | | | | | | | | | |
| Pllaka qeramike, mbetje e vjetër adezivi me rezistencë ndaj ujit, dysheme mastiku asfaltik | ~12 orë | | | | | | | | | | | | | |

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Në përgjithësi

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme, të jetë e pastër, e thatë dhe pa ndotës si pislëqë, vaj, graso, kore çimentoje, dyll, llak, mbetje adezivi të vjetër, veshje boje dhe skorje, llaç apo shtresa pluhuri të cilat mund të ndikojnë tek ngjitja. Pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrihet duhet të hiqet plotësisht nga të gjitha llojet e nënshtresave përpara aplikimit të Sikafloor®-01 Primer, preferohet me vakuum.

Dysheme betoni / çimentoje

Nënshtresat duhet të përgatiten mekanikisht me anë të pastrimit me rrymë abrazive, smerilizim, bluarje apo pajisje tjetër të përshtatshme. Mbushni çdo vrimë apo hapësirë me produktet e duhura kompatibël Sika® për riparimin e dyshemeve.

Dysheme sulfati kalciumi (anhidriti)

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe e sheshtë për të ofruar një sipërfaqe të lëmuar. Mbushni çdo vrimë apo hapësirë me produktet e duhura kompatibël Sika® për riparimin e dyshemeve ose nivelimit.

Druri

Nënshtresat me dysHEME prej druri (pllakë zdrukthi ose OSB) duhet të fiksohen në mënyrë të sigurtë mbi nënstrukturën. Largoni çdo parregullsi të sipërfaqes duke përdorur pajisjen e duhur për smerilizim.

Pllaka qeramike

Të gjitha pllakat duhet të jenë të qëndrueshme, të ngjitura mirë dhe të sigurta. Zëvendësoni ato që janë shkullur. Smerilizoni sipërfaqet për të hequr glazurën.

DysHEME magneziti

Nënshtresat duhet të lyhen me prajmerin Sikafloor® -02 Primer. Lexoni skedën teknike të produktit.

Lloje të tjera nënshtresash

Kontakttoni me shërbimin teknik Sika.

PËRZIERJA

Përzieni ose trazoni enën përpara përdorimit. Nëse kërkohet hollim me ujë, pas përzierjes së produktit, hidheni brenda një ene të pastër dhe përzieni me sasinë e duhur të ujit.

APLIKIMI

Ndriqni me rreptësi procedurat e instalimit siç përcaktohen në Method Statement, manualët e aplikimit dhe udhëzimet e punimeve të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve aktuale në kantier.

Aplikoni prajmerin mbi nënshtresën e përgatitur me rul, furçë ose pajisje të përshtatshme për spërkatje (raport përzierjeje të paktën 1:1). Sigurohuni se një veshje e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtresën. Mbi nënshtresat shumë absorbuese, mund të nevojitet aplikim i dytë. Shmangni mbledhjen e prajmerit në formë pellgu.

Konfirmimi se është arritur koha e pritjes / mbiveshjes, përpara aplikimit të produkteve vijuese.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos aplikoni mbi nënshtresa me lagështi në rritje.
- Lexoni shënimet e rëndësishme në skedat teknike të produkteve Sika® për nivelim ose kollave të pllakave që do të përdoren me Sikafloor®-01 Primer.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-01 Primer

Tetor 2019, Botimi 05.01

020815120010000042

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikafloor-01Primer-sq-AL-(10-2019)-5-1.pdf